

SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:

Ardian DVORANI	- Kryesues
Arjana FULLANI	- Anëtar
Evelina QIRJAKO	- Anëtar
Andi ÇELIKU	- Anëtar
Medi BICI	- Anëtar

Asistuar nga sekretarja Ermelinda Kadiu, sot me datë 07.02.2017 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen administrative që iu përket palëve:

PADITËS: **Sulltana (Tana) Bilbilaj** (*Në mungesë*).
I PADITUR: **Universiteti “Ismail Qemali Vlorë”** (*Në mungesë*).
OBJEKTI: *Dëmshpërblim i rrjedhur nga marrëdhënia e punës.*
BAZA LIGJORE: *Nenet 143, 144, 155 të Kodit Punës.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 990, datë 02.04.2012 ka vendosur:

Pranimin e padisë së paditësit Sulltana (Tana) Bilbilaj.

Detyrimin e palës së paditur Universitetit të Vlorës “Ismail Qemali” që të dëmshpërblejë paditësen Sulltana (Tana) Bilbilaj me pagën e 3 (tre) muajve për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.

Detyrimin e palës së paditur Universitetit të Vlorës “Ismail Qemali” që të dëmshpërblejë paditësen Sulltana (Tana) Bilbilaj me pagën e 10 (dhjetë) muajve për shkak të zgjidhjes së menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

Detyrimin e palës së paditur Universitetit të Vlorës “Ismail Qemali” që të dëmshpërblejë paditësen Sulltana (Tana) Bilbilaj me pagën e 4 (katër) muajve si dëmshpërblim për vjetërsi në punë.

Detyrimin e palës së paditur Universitetit të Vlorës “Ismail Qemali” që të dëmshpërblejë paditësen Sulltana (Tana) Bilbilaj me pagën e 2 (dy) muajve si dëmshpërblim për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 176, datë 06.02.2014 ka vendosur:

Shpalljen e moskompetencës lëndore të çështjes civile me paditëse Sulltana (Tana) Bilbilaj dhe i paditur Universiteti “I. Qemali” Vlorë, me objekt dëmshpërblimi si rrjedhojë e marrëdhënieve të punës. Dërgimin e akteve për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit.

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 3399, datë 15.09.2014 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 990, datë 02.04.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Ndaj vendimit të sipërcituar rezulton të ketë paraqitur rekurs pala e paditur Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë...

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë:

V E N D O S I

Lënien në fuqi të vendimit nr. 3399, datë 15.09.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit.

U shpall në Tiranë, me datë 07.02.2017
Nr. 31003-00299-00-2015 Regj. Themeltar
Nr.00-2017-55 Vendimi (29)